



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, Datë: 30.08.2013  
Nr.0204-1136

**Arben Çitaku**  
Sekretar i Përgjithshëm  
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

**Lënda:** Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar dy vendime lokale:

- **Vendimin për miratimin e planit zhvillimor komunal për periudhën 2013-2022;**
- **Vendimin për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të planit rregullues të lagjes "Tophane";**

Vendime të cilat janë miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe nënshkruara nga Kryesuesi i KK së Prishtinës, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, ju si ministri Kryesuese e Komisionit, po ju përcjellim për shqyrtim dhe vlerësim të ligjshmërisë këto Vendime lokale.

Bashkangjitur gjeni Vendimet e lartshënuara të Komunës së Prishtinës.

Me respekt,

**Besnik Osmani,**  
Sekretar i Përgjithshëm,

Kopje: Hidajete Zhuri -MMPH  
Shpend Agaj -MMPH  
Jeton Qela -MAPL  
Arkivës së MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Pristina, Dana: 30.08.2013  
Br.0204-1136

**Arben Çitaku**  
Generalni Sekretar  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja

**Predmet:** Propratni dopis

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalene samouprave je primilo dve lokalne odluke:

- Odluka o usvajanju opštinskog razvojnog plana za period 2013-2022;
- Odluka o početku izmene i dopune regulativnog plana naselja "Tophane";

Odluke koje su usvojene od Skupštine Opštine Pristina i potpisane od Predsedavajućeg SO Pristina, u cilju procene zakonitosti.

Na osnovu Odluke Vlade Br. 2/119 od dana 07.04.2010 za formiranje komisija za razmatranje lokalnih akata, vi kao ministarstvo Predsedavajuće Komisije, dostavljam vam na razmatranje i procenjivanje ovih lokalnih odluka.

U prilogu ćete naći gore navedene Odluke Opštine Pristina.

S poštovanjem,

**Besnik Osmani,**  
Generalni Sekretar,

Kopija: Hidajete Zhuri -MSPP  
Shpend Agaj -MSPP  
Jeton Qela -MALS  
Arhivi MALS-a



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 17, pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të neneve 15 dhe 20 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikim hapësinor, të nenit 11 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 2003/14, dhe të nenit 15, paragrafi 15.1, pika b dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.08.2013, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**PËR FILLIMIN E NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË PLANIT RREGULLUES**  
**TË LAGJES "TOPHANE"**

**I.**

Miratohet Vendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimin të Planit rregullues urban të lagjes "Tophane", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 35 - 579, të dt. 22.11.2005, plotësuar me Vendimin për plotësimin e dispozitave lidhur me realizimin e Planit rregullues "Tophane", 01 nr. 35 - 336, të dt. 24.7.2007, dhe Vendimit për plotësimin e mënyrës së realizimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane", 01 nr. 35 - 374, të dt. 3.4.2008.

**II.**

Me ndryshimet dhe plotësimet e Planit rregullues të lagjes "Tophane", do të rishqyrtohen elementet dhe përmbajtjet e paralizuar të planit nga pika I e këtij vendimi.

**III.**

Bartës i përgatitjes së detyrave për hartimin e Planit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Tophane", është Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

**IV.**

Për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Tophane", nga pika III e këtij vendimi, Komuna do të angazhojë kompani profesionale, sipas procedurave të parapara ligjore.

**V.**

Plani rregullues i përshkruar në pikën I të këtij vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar.

**VI.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës. Organet tjera të Administratës komunale do të kryejnë veprimet përkatëse nga përgjegjësitë e tyre me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.


**VII.**

Ky vendim hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljes dhe ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

01. nr. 035 - 156908, më 27.08.2013

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Sami Hamiti, ecc. i dipl.



Faqe 2 nga 2

HYRESE-ULAZNA INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal			
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije			
Ministry of Local Government Administration			
Data	27. 08. 2013		
Datum	27. 08. 2013		
Date	27. 08. 2013		
Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- III -	0204-1130	8	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2. pika d dhe nenit 17, pika b të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor dhe nenit 9 të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/14, për planifikim hapësinor dhe të dispozitave të nenit 15, pika b dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.08.2013, miratoi këtë

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL PËR PERIUDHËN 2013 - 2022**

**I.**

Miratohet Vendimi për miratimin e Planit zhvillimor komunal për periudhën 2013 - 2022.

**II.**

Plani i cekur në pikën I të këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

**III.**

1. Pjesa tekstuale e Planit përmban: profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e gjendjes, vizionin, parimet dhe caqet, kornizën e zhvillimit hapësinor, strategjitë dhe dispozitat për zbatim.

2. Pjesa grafike e Planit përmban të dhënat hartografike dhe pjesët tjera grafike, ku përshkruhet gjendja në hapësirë dhe ndërhyrjet në të.

3. Prezantimet hartografike të digjitalizuara të Planit paraqesin tërësinë e zgjidhjeve të planifikuara.

**IV.**

1. Në pjesën tekstuale të Planit paraqitet profili i gjendjes në komunën e Prishtinës, pozita, rëndësia dhe çështjet tjera specifike të territorit të komunës së Prishtinës, në kontest me Planin hapësinor të Kosovës, analizën e profilit me të cilën tregohen përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të komunës së Prishtinës, si dhe vlerësimet e ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor në këto zhvillime.

2. Përmbajtja e vizionit dhe parimeve paraqet të ardhmen e komunës së Prishtinës, caqet dhe prioritetet strategjike zhvillimore afatgjate.
3. Korniza e zhvillimit hapësinor komunal përmban strukturën dhe lokacionin hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm ekonomik: regjenerimit, turizmit, rekreacionit, tregtisë, transportit komunal, popullsisë, banimit, vendbanimeve, çështjeve sociale, trashëgimisë kulturore, mjedisit, duke përfshirë trashëgiminë natyrore, shënimin e zonës urbane ekzistuese dhe zgjerimet e propozuara për të ardhmen, si dhe ndërtimin jashtë zonës urbane dhe zonave ndërtimore të fshatrave.
4. Pjesa e zbatimit të Planit përbën kushtet e rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në komunë, destinimin e sipërfaqeve, zonat ndërtimore për vendbanime dhe strukturat ekzistuese jashtë zonave të vendbanimeve, kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve dhe sistemeve të tjera të infrastrukturës dhe masat për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.


VI.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 031-156871, më 27.08.2013

KRYESUESI I KUVENDIT  
Sami Hamiti, ecc. i dipl.



Faqe 2 nga 2